



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA SHETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE			
DRŽAVNA AGENCIJA ZA ZAŠTITU LIČNIH PODATAKA			
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA			
ZYRA E ARKIVIT-KANCELARIJA ARHIVA-ARCHIVE OFFICE			
Nyësia Org. Org. Jedm. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No:	02
Nr. i faqeve Broj strana No. pages	02	Data Datum Date:	10 / 03 / 20 16
PRISHTINE/A			

Nr. prot. 02/2016

Datë: 09.03.2016

Në mbështetje të nenit 29 (paragrafi 2, nënparagrafi 2.2) dhe nenit 42 (paragrafi 1) të Ligjit Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nenit 14 (paragrafi 2) të Rregullores Nr. 04/2015 për Procedurat e Brendshme për Shqyrtimin e Ankesave, Mbikëqyrësi Shtetëror, nxjerr:

VENDIM

1. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, SHPALLET jo-kompetente për të vendosur lidhur me Ankesën e dhe për të ndërmarrë veprime të mëtejshme lidhur me Ankesën e këtij subjekti.
2. Pas plotfuqishmërisë së këtij Vendimi, Ankesa bashkë me shtesat e saja i dërgohet Komisionerit për Mbikëqyrjen e Procesit të Përgjimeve, i cili bënë kontrollin e ligjshmërisë së përgjimeve të komunikimit.

ARSYETIM


Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejme Agjencia) me datë 31/12/2015 ka pranuar ankesë nga lidhur me atë që ankuesi pretendon se numri i telefonit të cilin e posedon , e i cili funksionon sipas shërbimeve që i ofron operatori "Vala" është duke u përgjuar.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoj Kërkesën e lartpërmendur, konstatoj se Kërkesa - çështja juridike e personit të lartpërmendur, nuk bien në kompetencë për vendosje të Agjencisë, pasi sipas përkufizimit të dhënë në nenin 2 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.19) të Ligjit Nr. Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia është cilësuar si agjencion i pavarur, përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale, të definuara me dispozitat e nenit 2 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.1) të Ligjit Nr. Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale , e jo përgjegjës për përcjelljen apo kontrollin e përgjimeve të komunikimeve.

Sipas vlerësimit të Agjencisë, çështja e procedurës dhe kontrollit të përgjimeve dhe komunikimeve është në kompetencë të Komisionerit për Mbikëqyrjen e procesit të Përgjimeve, i cili bënë mbikëqyrjen dhe kontrollin e ligjshmërisë të përgjimeve dhe komunikimeve sipas procedurës së paraparë me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-030 për Përgjimet e Komunikimeve Elektronike, kështu që për shkaqet e lartpërmendura Agjencia vendosi sikurse në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë Juridike:

Ky Vendim është përfundimtar në procedurë administrative, kurse pala e pakënaqur brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, mund të paraqes padi në gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh, për të vërtetuar se shkelja ka ekzistuar.



Iu dërgohet:

- Ankuesit,
- Arkivit të Agjencisë.